

# HIDROFAS GRUND

Nënshtresë "struktuore" që siguron një sipërfaqe uniforme dhe të ngurtësuar përpara aplikimit të suvasë dekorative të përfunduar

## FUSHA E APLIKIMIT

Hidrofas Grund është nënshtresë struktuore e destinuar për nivelimin dhe forcimin e sipërfaqes në të cilën aplikohet suvasa dekorative e përfunduar: Hidrofas (1mm; 1.5mm; 2mm), Hydrofas 3, Adingfas (1mm; 1.5mm; 2mm) dhe Adingfas 3. Hidrofas Grund përdoret për përpunimin e nënshtresave të bëra me çimento dhe suvasë të zgjatur, sipërfaqe betoni dhe sipërfaqe të lëmuara me përzierje lëmuese çimentoje.

## VETITË

- veshje një komponentësh me bazë polimer;
- mundësia e ngjyrosjes në të njëjtën ngjyrë si suvasa dekorative;
- stabilizon dhe siguron vrazhdësi të nënshtresës;
- e përmirëson ngjitjen;
- përgaditje dhe performansë e thjeshtë;
- i përshkueshëm nga avulli;
- ekologjik.

## KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

CILËSITË	METODA	VLERA E DEKLARUAR
Dukje	-	përzierje e ngjyrosur e pastëzuar
Dendësia	EN ISO 2811-1	1,57-1,63 g/cm <sup>3</sup>
Madhësia e mbushësit	-	< 0,30%mm
Adezion për nënshtresën pas 28 ditë nga ngulitja	EN ISO 4624	≥ 1,0 MPa
Koha e tharjes në 20°C, në lagështi relative të ajrit prej 50- 60%	-	12h

## METODOLOGJIA E PERFORMANCËS

### PREGADITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e shëndetshme, e fortë, e thatë, e pastër, e pa yndyrë, pa pluhur dhe pa pjesë të paqëndrueshme. Temperatura e nënshtresës dhe e ajrit duhet të jetë ndërmjet +5°C dhe +35°C, me një lagështi relative të ajrit deri në 50-60%. Sipërfaqet që do të përpunohen në momentin e instalimit nuk duhet të ekspozohen drejtpërdrejt ndaj diellit, shiut dhe rrymave të forta.

### PREGADITJA E MATERIALIT

Materiali përgatitet duke u holluar me ujë deri në 20%, pas së cilës përzihet deri në homogjenizimin e plotë.

### INSTALIMI

Instalimi kryhet me fuqë ose rul në një shtresë, në mënyrë të barabartë në të gjithë sipërfaqen dhe pa thyerje. Nëse është e nevojshme, në rastin e sipërfaqeve të vjetra dhe shumë poroze, mund të kryhet dy herë astartimi me një periudhë kohore 2-3 orë ndërmjet dy shtresave. Rekomandohet që nuanca e Hidrofas Grund të jetë e njëjtë me nuancën e suvasë dekorative përfundimtare. Intervali kohor për aplikimin e

shtresës tjetër të suvasë dekorative në temperaturë 20°C, me lagështi relative të ajrit 50-60% është 12 orë. Sipërfaqet e trajtuara duhet të mbrohen nga rrezet e diellit direkte, rrymat e forta, ngrica dhe pluhuri deri në momentin e aplikimit të materialit tjetër ose derisa materiali të jetë ngurtësuar plotësisht (tharja). Temperatura e nënshtresës dhe e ajrit gjatë aplikimit duhet të jetë nga 5°C deri në 30°C. Lagështia e lartë e ajrit dhe temperaturat e ulëta gjatë instalimit mund të zgjasin ndjeshëm kohën e tharjes.

Shënim: Konsumi i përshkruar i materialit, kur aplikohet me spërkatje me makinë mund të rritet, në varësi të kushteve gjatë instalimit.

## KONSUMI

0.20-0.25kg/m<sup>2</sup>

## PASTRIMI

Mjetet dhe pajisjet pastrohen me ujë menjëherë pas përdorimit.

## PAKETIMI

Kova plastike prej 5 deri 25 kg.

## RRUAJTJA

Në ambalazh origjinal të mbyllur , në hapsira të thata , në temperaturë prej 5-30°C. Afati i përdorimit 12 muaj.

Rreziku për shëndetin: Është e nevojshme të shmangni kontaktin e produktit me lëkurën (përdorni doreza mbrojtëse). Materiali nuk është toksik, por në rast kontakti të papritur, në rast kontaminimi të sipërfaqeve të lëkurës, ato duhet të lahen menjëherë me sapun dhe ujë. Nëse materiali spërkat në sy, është e nevojshme që menjëherë të shpëlahet me shumë ujë dhe të kërkoni ndihmë mjekësore.

Zjarri: Hidrofas Grund është një masë paste jo e ndezshme. Informacion shtesë jepet në Fletën e sigurisë së produktit.

Pastrimi dhe asgjësimi: Mbetjet e palidhura të Hidrofas Grund pastrohen me ujë. Ambalazhet e vjetra të përdorura duhet të hidhen sipas rregulloreve lokale për atë lloj mbetjeje.

Rekomandojmë që mënyra e aplikimit dhe sasi të nevojshme të përshtaten me kushtet e objektit, si dhe aplikimin e detyrueshëm të pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse.